



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	29.01.2025
REFERENC-Ë:	24/6454/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Deco Trans LTD" Sh.p.k. Prishtinë, Trajtim fizik i gomave të përdorura të automjeteve, Bllacë, Suharekë.
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
RTEMA/SUBJEKAT/SUBJECT :	Vendim për vazhdimin e Lejes Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për vazhdimin e Lejes Mjedisore të operatorit, "Deco Trans LTD" Sh.p.k. Prishtinë, për veprimtarinë: Trajtim fizik i gomave të përdorura të automjeteve, Bllacë, Suharekë.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 24/6454/MMPHI
Datë: 29.01.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 2 të nenit 17 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatorit, "Deco Trans LTD" Sh.p.k. Prishtinë, me nr. prot. 24/6454/MMPHI i **vazhdohet Leja Mjedisore**, për veprimtarinë: Trajtim fizik i gomave të përdorura të automjeteve, në ngastrën nr.P-72116003-02865-0 zona kadastrale, Bllacë, Suharekë.
2. Operatori obligohet:
 - 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
 - 2.2. Të mirëmbahen kolektorët në sipërfaqet operacionale, për të siguruar rrjedhje normale të tretësirave të lëngëta të ndotura, për në pajisjen e trajtimit të tyre;
 - 2.3. Të sistemohen gomat e përdorura brenda sipërfaqes operuese;
 - 2.4. Për sistemin e menaxhuar mjedisor të ketë personin përgjegjës të **profilit mjedisor**.

Faqe 2 nga 4



- 2.5. Të përmbahet dispozitave të Ligjit për Mbeturinat;
- 2.6. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike, me ndikim në mjedisi, të njoftoi MMPHI;
- 2.7. Për zgjerim te kapacitetit dhe ndryshim te veprimtarisë, operatori obligohet te njoftoje MMPHI- ne;
- 2.8. Pas përfundimit të veprimtarisë, operatori është i obliguar të bëjë rehabilitimin dhe rikultivimin e lokacionit;
- 2.9. Afati i lejes Mjedisore është për periudhën 5 (pesë) vjeçare nga dita e lëshimit te këtij vendimi.

A r s y e t i m

Është shqyrtuar kërkesa për Leje Mjedisore për operatorin, "Deco Trans LTD" Sh.p.k. Prishtinë, me nr. prot. 24/6454/MMPHI për vazhdimin e Lejes Mjedisore, për veprimtarinë: Trajtim fizik i gomave të përdorura të automjeteve, në ngastrën nr. P-72116003-02865-0 zona kadastrale, Bllacë, Suharekë.

Operatori ka bashkangjitur dokumentacionin:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr.13/99, të dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me Nr. 19/4006/1-ZSP/411/19, të lëshuar me dt. 07.08.2019;
- Leja Mjedisore nr.19/5147/ZSP/541/19, të lëshuar me dt. 26.11.2019;
- Vendim nga Komuna e Suharekës nr. 244, të lëshuar me datë: 07.06.2019;

Andaj bazuar ne dokumentacionin e dorëzuar dhe plotësuar nga pala dhe gjendjes faktike duke përfshi shikimin ne vend me zyrtaret profesional sipas legjislacionit ne fuqi për mjedisin dhe Udhëzimit Administrativ te MMPHI- se Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore janë paraqitur kushtet si ne dispozitiv.

Afati i përcaktuar i lejes mjedisore ne dispozitiv është në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 17 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Suharekë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.